



Prishtinë, 27 gusht 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1275_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084)
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrale kadastrale Nr. 00032-0, 00033-0, 00035-0 dhe 00036-0, ZK Novosell, Prishtinë me kapacitet të instaluar prej **30 kW** në Komunën e Prishtinës, të datës 01.07.2020 të aplikuesit "VIER PFOTEN KOSOVA", me adresë: "Te Parku i Arinjëve" Mramor, Komuna Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 27 gusht 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "VIER PFOTEN KOSOVA", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ndërtuar sipas Lejes Ndërtimore 05Nr.351-311558 të dt. 08.05.2017 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, në parcelën ngastrale kadastrale Nr. 00032-0, 00033-0, 00035-0 dhe 00036-0, ZK Novosell, Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Prishtinës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "VIER PFOTEN KOSOVA", me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR-90089688 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.



- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi “VIER PFOTEN KOSOVA”, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

Arsyetim

- ZRRE, me datë 04.08.2020 nga aplikuesi “VIER PFOTEN KOSOVA”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastrale kadastrale Nr. 00032-0, 00033-0, 00035-0 dhe 00036-0, ZK Novosell, Mramor - Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Prishtinës.
 - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 5512 të datës 23.07.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 05-350/02-62405/20 të datës 29.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit “VIER PFOTEN KOSOVA”, dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin parcelën ngastrale kadastrale Nr. 00032-0, 00033-0, 00035-0 dhe 00036-0, ZK Novosell, Mramor - Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Prishtinës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

